



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 157, datë 15.05.2020

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.89, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, duke mbajtur parasysh kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit të kandidimit (datë 06.05.2020) për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 89, datë 26.02.2020 dhe faktin se kandidatët janë në proces e sipër verifikimi të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin e tij nr. 88, datë 26.02.2020, si dhe faktin që aplikimi i një prej kandidatëve është depozituar mbas përfundimit të afatit të kandidimit,

V E N D O S I :

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Për kandidatet znj. Daniela Shirka dhe znj. Miliana Muça, të cilat kanë aplikuar edhe për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020.
3. Mospërfshirjen në listën e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të znj. Ilirjana Olldashi, për shkak të aplikimit mbas përfundimit të afatit kandidimit për këtë pozicion të lirë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR